



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e
Përgjithshme Detare

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
AUDITIM FINANCIAR

Tiranë, mars 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-8
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-5
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	HYRJA	7-11
1	Objektivat dhe qëllimi	7-8
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e vlerësimit	9-10
6	Standardet e auditimit	10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-12
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Auditim mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.	12-19
2.2	Auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.	20-23
2.3	Auditim mbi evidencën kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij nga organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.	23-39
IV	REKOMANDIME	39-42

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Drejtoria e Përgjithshme Detare (DPD) është institucioni qendror shtetëror që ka për detyrë organizimin, administrimin dhe kontrollin e veprimtarisë detare në Republikën e Shqipërisë. Kjo drejtori vepron në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare detare, duke garantuar sigurinë e lundrimit, mbrojtjen e jetës njerëzore në det dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

DPD merret me regjistrimin dhe certifikimin e anijeve, licencimin dhe certifikimin e detarëve, inspektimin teknik të mjeteve lundruese, si dhe monitorimin e aktiviteteve portuale dhe detare. Gjithashtu, ajo përfaqëson shtetin shqiptar në organizata dhe marrëveshje ndërkombëtare detare, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit detar dhe transportit detar në vend.

Drejtoria e Përgjithshme Detare është drejtori në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe financohet nga buxheti i shtetit si një institucion public dhe gjeneron edhe të ardhura të veta.

Referuar programit ekonomik financiar të Drejtorisë gjatë vitit 2023-2024 janë miratuar 18 tarifa për shërbime të cilat jepen nga kjo drejtori. Gjatë vitit 2023 të ardhurat nga tarifat janë në vlerën 25,327 mijë lekë dhe të ardhurat gjatë vitit 2024 në vlerën 27,602 lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i Drejtorisë së Përgjithshme Detare është thelbësor për të siguruar përdorimin e drejtë, efikas dhe transparent të fondeve publike. Ai ndihmon në verifikimin e ligjshmërisë së shpenzimeve, rrit përgjegjshmërinë e institucionit dhe parandalon keqmenaxhimin financiar. Përmes auditimit përmirësohet performanca institucionale, forcohet besimi i publikut dhe sigurohet që burimet financiare të përdoren për përmbushjen e objektivave të institucionit dhe interesit publik.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024. Në këtë kontekst, qëllimi i auditimeve financiare është që të japë garanci dhe të rrisë nivelin e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Drejtoria e Përgjithshme Detare. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të Drejtorisë.
- Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.
- Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i

punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për vitin që auditohen pasqyrat financiare (2024) niveli i materialitetit pranohet në vlerën 510 mijë lekë dhe gabimi i lejuar (10% - 20%) në vlerën 51 mijë lekë për t'u konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruar nga vetë subjekti. Mbi transaksionet u aplikuan: - teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli).

Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 6 gjetje dhe ka dhënë 6 rekomandime të karakterit organizativ.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- Nga auditimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 dhe 2024-2026 të përgatitura u konstatua se, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP), për përgatitjen e PBA-ve, si dhe nuk ka dokumentim të mbledhjeve të tij. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga Drejtoria e Financës.

- Nga auditimi u konstatua se në përmbajtjen e raporteve të monitorimit, subjekti ka përshkruar/pasqyruar veprimtarinë e institucionit, si dhe të dhëna në terma sasiorë, por nuk është kryer një analizë e mirëfilltë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosrealizimet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit. Gjithashtu u konstatua se në raportin e 12 mujorit të vitit 2024 nuk janë përgatitur anekset nr.1 aneksi nr.1.1 dhe aneksi nr.1.2. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 49 të Udhëzimit të MF nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore*" dhe Udhëzimin e MF nr.9, datë 20.7.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, pika 267.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024, rezultoi se llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 2,757,993 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga kjo vlerë, në këtë llogari janë kontabilizuar 3 ngurtësime në shumën 2,181,588 lekë, për të cilat ka kaluar afati. Për projektet të cilat ka mbaruar afati i garancisë dhe këto investime nuk kanë shfaqur problematika, në bazë të raporteve të vlerësimit të mbajtur duhet të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e garancive të bllokuara.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme Detare të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit çdo vit për përgatitjen e PBA-së, si detyrim për të garantuar një proces planifikimi sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

-Të merren masa nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues për monitorimin e zbatimit të Buxhetit ku të identifikojnë mosrealizimet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

- Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme që urdhrat për dërgimin me shërbim jashtë qendrës së punës të miratohen para kryerjes së shërbimit.

- Autoriteti Kontraktor të marrë masa për kryerjen e klasifikimit të saktë të natyrës së punimeve, përpara nisjes së procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratave, duke përcaktuar në mënyrë të dokumentuar natyrën e punimeve si mirëmbajtje apo rikonstruksion/ndërtim.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2024:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme Detare për vitin ushtrimor 01.01.2024-31.12.2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar me theksim çështje¹:

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare më 31 dhjetor 2024, referuar Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” të ndryshuar.

Baza për opinionin:

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, shpjegimet që janë përfshirë në deklaratat financiare dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare

¹ Një opinion me “Theksim Çështjeje”, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.

nuk përmbajnë gabime materiale. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 2,230 mijë lek.

Theksimi i çështjes:

- Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në fund të vitit 2024 janë kontabilizuar në këtë llogari 3 ngurtësime më vlerën 2,181,588 lekë, për të cilat ka kaluar afati.

- Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në 31.12.2024 është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 170,475,206 lekë. Në këtë llogari referuar analizës analitike të zërave janë kontabilizuar ndërtesat sëbashku më rikonstruksionet që kanë pësuar gjatë viteve për Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Kapiteneritë e Vlorës, Sarandës dhe Lezhës. Këto aktive edhe pse janë në përdorim të institucioneve të sipërpërmenduar nuk disponohet dokumentacion i cili vërteton pronësinë për këto ndërtesa.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1050/1 prot., datë 05.11.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 04.11.2025 deri më datë 24.12.2025, në subjektin Drejtoria e Përgjithshme Detare për periudhën nga data 01.01.2023 deri më datën 30.09.2025 u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.H., Përgjegjës grupi
2. S. D., auditues
3. A.Z., auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023-2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të Drejtorisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Projekt Raporti i Auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

2. Identifikimi i çështjes.

Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për

përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.²

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia dhe vlerësimi, periudha, klasifikimi dhe kuptueshmëria, ligjshmëria dhe rregullsia, ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

² Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme Detare është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 4, datë 26.01.2024 “*Për miratimin e manualit të MFK*”;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFEnr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; ; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit

ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; ISSAI 400 “*Parimet*

themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 3 akt-konstatime. Gjatë hartimit të projekt-raportit, sipas përcaktimeve ligjore janë paraqitur kundërshtime nga subjekti Drejtoria e Përgjithshme Detare si më poshtë.

Me shkresën nr.2986 prot, datë 29.12.2025 dhe nr.28684/6 prot, datë 30.12.2025 është observuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm:

Drejtoria e Përgjithshme Detare është një institucion qeveritar i Republikës së Shqipërisë nën juridiksionin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo drejtori është organi kryesor shtetëror që administron, kontrollon dhe koordinon aktivitetet detare në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin vendas dhe konventat ndërkombëtare në fushën e detarisë. Është themeluar zyrtarisht më 2 prill 2009 sipas Ligjit Nr. 10109, “*Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë*”, duke zbatuar edhe Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë. Kjo Drejtori e ushtron veprimtarinë e saj duke ju referuar ligjeve, VKM, dhe udhëzimeve të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës si më poshtë.

-Ligji Nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”;

-Ligji Nr. 168/2013 “Për Sigurinë në Anije dhe në Porte”;

-Ligji Nr. 127/2020 “Për regjistrimin, përdorimin dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”;

-Urdhri Nr. 446, datë 18.12.2019, për miratimin e Rregullores së Brendshme të DPD-së.

Drejtoria ka një gamë të gjerë detyrash dhe përgjegjësish që lidhen me menaxhimin dhe mbikëqyrjen e fushës detare.

- Drejtimi dhe koordinimi i strukturave të administratës detare në Shqipëri.
- Kontrolli dhe monitorimi i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve detare, si ato kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.

- Mbikëqyrja e sigurisë detare, duke ngritur grupe ekspertësh për hetimin e aksidenteve, incidenteve detare, përplasjeve të anijeve, zjarreve etj.
- Asistencë teknike në hartimin dhe përafrimin e aktet nënligjore në fushë detare.
- Trajnime dhe certifikime për oficerë detarë, pilotë, agjentë dhe operatorë portualë sipas standardeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.
- Zbatimi i politikave të transportit detar në përputhje me planet kombëtare të zhvillimit të transportit.
- Monitorimi i zhvillimit të porteve të vendit, bazuar në studime dhe strategji zhvillimi.

Rëndësia e Drejtorisë

Ky institucion ka një rol kyç në:

- Sigurimin e sigurisë detare
- Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit detar dhe
- Zbatimin e standardëve ndërkombëtarë në veprimtaritë e detarisë në Shqipëri.

Auditimi i Drejtorisë së Përgjithshme Detare (DPD) ka rëndësi të veçantë për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), sepse lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e interesit publik dhe ushtrimin e kontrollit të jashtëm shtetëror në një sektor strategjik.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditim mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë.

Në zbatim të këtij drejtimi të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MIE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
4. Akt Rakordimi i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit;
5. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi.

I. Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA dhe programimit të buxhetit vjetor:

-Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme PBA 2023-2025, 2024-2026 dhe 2025-2027.

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026 u konstatua se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për PBA 2023-2025 me Urdhrin nr.15 prot., datë 02.02.2023

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 13/1prot., datë 29.01.2024.

- Për realizimin e fazave të përgatitjes PBA është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për PBA 2024-2026 me Urdhrin nr. 04 prot., datë 09.01.2025.

-Faza e parë e PBA 2024-2026 dhe pas rekomandimeve të MIE, është bazuar Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr. 5 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

PBA 2024-2026, është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 628 prot., datë 27.04.2023.

- Faza e dytë e PBA 2024-2026 është bazuar Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 22 datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026” dhe është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 628/1 prot., datë 16.08.2023.

Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2023-2025 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten në tabelën e mëposhtëme.

Tabela nr. 1: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2023-2025 sipas llogarive

000/lekë

Nr	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	79,423	67.2	79,823	57.3	81,774	45.1
2	Sigurime (601)	13,577	11.5	13,677	9.8	14,080	7.8
3	Shpenzime operative (602)	17,000	14.3	27,000	19.4	35,200	19.4
4	Shpenzime (606)	254	0.2	320	0.2	300	0.2
5	Shpenzime për investime (230-231)	8,155	6.8	18,500	13.3	50,000	27.5
TOTALI		118,409	100	139,320	100	181,354	100

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës e rezultoi se, për vitin 2023 janë planifikuar shpenzime në vlerën 118,409 mijë lekë, për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime në vlerën 139,320 mijë lekë dhe për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime në vlerën 181,354 mijë lekë. Për vitin 2023 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 79,423 mijë lekë ose në masën 67.2%. Për sigurime shoqërore janë planifikuar shpenzime në vlerën 13,577 mijë lekë ose 11.5%. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 17,000 mijë lekë ose 14.3%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 8,155 mijë lekë ose 6.8%. Për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 79,823 mijë lekë ose në masën 57.3%, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 13,677 mijë lekë ose në masën 9.8 %, për shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 27,000 mijë lekë ose në masën 19.4%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 18,500 mijë lekë ose në masën 13.3%. Për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 81,774 mijë lekë ose në masën 45.1%. Shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 14,080 mijë lekë ose në masën 7.8%. Janë planifikuar për shpenzime operative 35,200 mijë lekë ose në masën 19.4%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 50,000 mijë lekë ose në masën 27.5%.

Tabela nr. 2: Planifikimi i shpenzimeve në PBA 2024-2026 sipas llogarive dhe peshës specifike që zënë ato në totalin e shpenzimeve paraqiten si mëposhtë:

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2024		Viti 2025		Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	114,490	66.5	115,997	72.7	117,529	73.7
2	Sigurime (601)	18,947	11	19,192	12	19,442	12.2
3	Shpenzime operative (602)	19,250	11.2	19,250	12.1	19,250	12
6	Shpenzime (606)	320	0.2	300	0.2	250	0.1
8	Shpenzime për investime (230-231)	19,000	11.1	4,822	3	2,896	2
TOTALI		172,007	100	159,561	100	159,367	100

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Financës e Drejtoria e Përgjithshme Detare rezultoi se, për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime në vlerën 172,007 mijë lekë, për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime në vlerën 159,561 mijë lekë dhe për vitin 2026 janë planifikuar

shpenzime në vlerën 159,367 mijë lekë. Për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 114,490 mijë lekë ose në masën 66%. Për sigurime shoqërore janë planifikuar shpenzime në vlerën 18,947 mijë lekë ose 11%. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 19,250 mijë lekë ose 11.2%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 19,000 mijë lekë ose 11.1%. Për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 115,997 mijë lekë ose në masën 72.7%, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 19,192 mijë lekë ose në masën 12%, për shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 19,250 mijë lekë ose në masën 12%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 4,822 mijë lekë ose në masën 3%. Për vitin 2026 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 117,529 mijë lekë ose në masën 73.7%. Shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 19,442 mijë lekë ose në masën 12%. Janë planifikuar për shpenzime operative 19,250 mijë lekë ose në masën 12%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 2,896 mijë lekë ose në masën 2%.

Tabela nr. 3: Planifikimi i shpenzimeve për PBA 2025-2027 sipas llogarive dhe peshës specifike që ato zënë në totalin e shpenzimeve paraqiten si mëposhtëm: 000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas llogarive	Viti 2025		Viti 2026		Viti 2027	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	123,616	67.7	124,638	71	125,752	74.6
2	Sigurime (601)	20,465	11.2	20,629	11.8	20,808	12.3
3	Shpenzime operative (602)	19,250	10.5	21,750	12.4	21,750	12.9
6	Shpenzime (606)	300	0.2	250	0.2	280	0.2
8	Shpenzime për investime (230-231)	19,000	10.4	8,125	4.6	0	0
	TOTALI	182,631	100	175,392	100	168,590	100

Burimi: Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga drejtoria financës në Drejtorinë e Përgjithshme Detare rezultoi se, për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime në vlerën 182,631 mijë lekë, për vitin 2026 janë planifikuar shpenzime në vlerën 175,392 mijë lekë dhe për vitin 2027 janë planifikuar shpenzime në vlerën 168,590 mijë lekë. Për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 123,616 mijë lekë ose në masën 67.7%. Për sigurime shoqërore janë planifikuar shpenzime në vlerën 20,465 mijë lekë ose 11.2%. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 19,250 mijë lekë ose 10.5%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 19,000 mijë lekë ose 10.4%. Për vitin 2026 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 124,638 mijë lekë ose në masën 71%, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 20,629 mijë lekë ose në masën 11.8%, për shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 21,750 mijë lekë ose në masën 12.4%. Shpenzime për investime janë planifikuar në vlerën 8,125 mijë lekë ose në masën 4.6%. Për vitin 2027 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 125,752 mijë lekë ose në masën 74.6%. Shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 20,808 mijë lekë ose në masën 12.3%. Janë planifikuar për shpenzime operative 21,750 mijë lekë ose në masën 12.9%. Nga auditimi i Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 dhe 2024-2026 të përgatitura u konstatua se në institucionin Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-ve, si dhe nuk ka dokumentim të mbledhjeve të EMP- së. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga Drejtoria e Financës, veprime në kundërshtim me udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5.

II. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet buxhetore.

Gjatë vitit 2023 është janë kryer ndryshimet në buxhet me shkresën nr. 1583/2 prot., datë 28.02.2023 ku është pakësuar zëri 602 në shumën 44,000 lekë dhe është shtuar në artikullin 606. Me shkresën nr. 6946/6 prot., datë 10.10.2023 është shtuar fondi për artikujt 600-601 për vlerën 11,600 lekë. Me shkresën nr. 9854/37 prot., datë 09.01.2024 është pakësuar fondi për paga me 5,000,000 lekë. Me shkresën nr. 223/2 prot., datë 19.01.2024 është shtuar fondi në llogarinë 600 me 20,000 lekë. Gjatë vitit 2024 me shkresën nr. 1663/14 prot., datë 20.11.2024 është shtuar llogaria 606 me 320,000 lekë. Me shkresën nr. 10006/8 prot., 31.12.2024 është pakësuar llogaria 600 në vlerën 11,000,000 lekë për vitin 2024. Me shkresën nr. 10152/3 prot., datë 09.01.2025 është shtuar llogaria 606 në vlerën 75,000 lekë. Me shkresën nr. 3987/6 prot., datë 30.06.2025 është shtuar llogaria 606 në vlerën 50,000 lekë. Në tabelat e mëposhtme gjendet informacioni mbi ndryshimet buxhetore:

Tabela nr.4: Ndryshimet buxhetore për vitin 2023

000/lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Ndryshimet gjatë vitit 2023	
	Pakesime	Shtesa
Art. 600 Paga	5,000	10,020
Art. 601 Sig. shoq.e shëndetësore		1,600
Art.602 Shpenzime operative	44	
Art. 606 Transf të buxhet familja,individ		44
Total	5,044	11,664

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Tabela nr.5: Ndryshimet buxhetore për vitin 2024

000/lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Ndryshimet gjatë vitit 2024	
	Pakesime	Shtesa
Art. 600 Paga	11,000	
Art. 606 Transf të buxhet familja,individ		78
Total	11,000	78

Burimi: Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

Tabela nr.6: Ndryshimet buxhetore për vitin 2025

000/lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Ndryshimet gjatë vitit 2025	
	Pakesime	Shtesa
Art. 606 Transf të buxhet familja,individ		50
Total	0	50

Burimi: Drejtoria e Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

Drejtorja e Përgjithshme Detare në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.10109, datë 02.04.2009 “Për Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë”, miraton lejet për ushtrimin e veprimtarisë detare të personave fizikë dhe juridikë. Tarifat për shërbimet e kryera nga DPD janë të miratuara me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 1289/1, datë 04.05.2021 “Për përcaktimin e tarifave të regjistrimit të mjeteve lundruese”.

Për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Përgjithshme Detare siguron të ardhurat për shërbimet e ofruara si më poshtë:

- Të ardhura nga Taksa portuale: Kjo taksë mbështetet në Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, neni 4, pika 1, ku citohet se: “1. Taksa portuale është 1 euro, kjo taksë paguhet, për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë e që kryejnë veprime tregtare.

- Të ardhura nga Pasaportat e lundrimit: Kjo e ardhur është e mbështetet në Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare” dhe është miratuar me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 10, datë 30/01/2009 “Për

përcaktimin e tarifave së regjistrimit të mjeteve lundruese”, pika 2, citohet se: “Personat të cilat pajisen me pasaportë lundrimi, paguajnë një tarifë shërbimi prej 5,750 lekë/personi, për të cilën nuk aplikohet TVSh”.

- Të ardhurat nga shërbimet për të tretët: Këto shërbime janë të mbështetura në Ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe miratuar me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 1289/1, datë 04.05.2021 “Për përcaktimin e tarifave të regjistrimit të mjeteve lundruese”.

Tabela nr.7: Shërbimet e miratuara dhe tarifat e vendosura sipas udhëzimit të sipërcituar, janë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Tarifa e miratuar
1	Tarifë e certifikatës së regjistrimit	10.000
2	Regjistrim mjete pa motor	1.500
3	Regjistrim mjete me motor	6.500
4	Leje lundrimi	3.500
5	Dëshmi kualifikimi për peshkatarët	900
6	Dëshmi kualifikimi për detarët (STCË -78/95)	1.600
7	Ndryshimi i pronësisë së mjetit	2.000
8	Zgjatje afati i lejes së lundrimit	5.000
9	Çregjistrim i mjeteve detare pa motor	500
10	Çregjistrimi i mjeteve detare me motor me aftësi lundrimi deri në 6 milje nga bregu	2.000
11	Çregjistrimi i mjeteve detare me aftësi mbi 6 milje nga bregu	5.000
12	Pranimi i protestave detare	5.000
13	Lëshimi i certifikatës minimumit	1.000

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

II/I. Të ardhura nga gjopa

Kjo e ardhur është e mbështetur në Ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprat e kundërligjshme të shkeljeve detare. Me UKM nr.153, datë 25.11.2019 “Marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data 1.01.2020”, Drejtoria e Përgjithshme Detare ka filluar ofrimin e shërbimeve on-line në platformën e-Albania, pasi të gjitha shërbimet ofrohen vetëm on-line në Platformën e-Albania.

Tabela nr.8: Realizimi i të ardhurave për vitet 2023, 2024 dhe 9-mujori 2025 paraqitet sipas tabelës më poshtë:

lekë

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Tarifa e miratuar	Sasia për Viti 2023 lëkunduar	Vlera për 2023	Sasia për Viti 2024	Vlera për 2024	Sasia për 9 mujori 2025	Vlera për 9-mujorin 2025
1	Taksa Portuale	1	8,607	860,765	7,648	761,752	4685	457,608
2	Pasaporta Lundrimi	5,750	282	1,621,500	243	1,397,250	165	948,750
I	Shuma (1-2)			2,482,265		2,159,002		1,406,358
3	Dëshmi Pronësie	5,000	0	0	0	0	0	0
4	Dëshmi Flamuri	5,000	0	0	0	0	0	0
5	Regjistrim mjete pa motor	1,500	59	88,500	85	127,500	70	105,000
6	Regjistrim mjete me motor	6,500	491	3,19,1500	724	4,706,000	727	4,725,500
7	Leje Lundrimi	3,500	1,291	4,518,500	1,479	5,176,500	1,402	4,907,000
8	Dëshmi kualifikimi	900	1,626	1,463,400	1,659	1,493,100	1,400	1,260,000
9	certifikatë STCË 95	1,600	950	1,520,000	820	1,312,000	640	1,024,000
10	Ndryshim pronësie i mjetit	2,000	559	1,118,000	552	1,104,000	497	994,000
11	Zgjatja e afatit të lejes së Lundrimit	5,000	1,696	8,480,000	1,793	8,965,000	1,930	9,650,000
12	Çregjistrim i mjeteve pa motor	500	0	0	-	-	1	500
13	Çregjistrim i mjeteve me motor deri 6 milje	2,000	8	16,000	2	4,000	2	4000

14	Cregjistrim i mjeteve me motor mbi 6 milje	5,000	1	5,000	2	10,000	3	15,000
15	Pranim Protestë detare	5,000	8	40,000	4	20,000	4	20,000
16	Certifikate Regjistrimi	10,000	55	55,000	51	51,000	97	970,000
17	certifikatë Minimumi	1,000	38	38,000	34	34,000	43	43,000
18	Derdhur tepër nga te trete			1,36,6690		1,823,071		750925
II	Shuma (3-18)			22,395,590		25,285,171		24,468,925
19	Të ardhura nga gjobat		0	0	0	0	0	0
20	Të ardhura nga qira objekti		1	179,390	1	153,640	1	180,000
21	Te ardhurat nga shitja AQ		5	270,000	1	4,800	0	0
III	Shuma (19-21)		6	449,390	2	158,440	1	180,000
TOTAL TE ARDHURAVE (I+II+III)				25,327,245		27,602,613		26,055,283

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Për shërbimin on-line, të ardhurat janë të gjitha të ardhura të parapaguara. Subjektet para se të aplikojnë në platformë marrin faturën për arkëtim dhe kur aplikojnë për shërbimin që duan, një nga dokumentacionet që kërkohet është ngarkimi i mandat pagesës. Ndërsa, të ardhurat nga gjoba janë të ardhura të cilat arkëtohen pas marrjes së gjobës ose proces verbalit për inspektimin e kryer. Për periudhën objekt auditimi janë pa arkëtuar: gjoba, përkatësisht: Agjencia “G. T.”, nr. serie 2. (Vlorë), data 10.08.2018, vlera 2,000 euro dhe 2. Agjencia “M. Y.”, nr. serie 001 (Sarandë), 25.08.2021, vlera 2,500 euro dhe nr. serie 00164 datë 31.07.2023 vlera 950 euro, Agjencia “A.F.” nr. Serie 0000. datë 11.05.2023, vlera 2500 euro sipas të dhënave të DPD sipas mandatat të bankës është kryer pagesa në datën 05.12.2025. Për periudhën objekt auditimi janë siguruar këto të ardhurat nga taksa portuale janë të ardhura për çdo prekje, për të gjitha anijet që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë, ky shërbim, ofrohet si on-line dhe me njoftime nga subjektet e interesuara.

Drejtoria e Përgjithshme Detare këto të ardhura i derdh çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Të ardhurat nga pasaportat e lundrimit janë të ardhurat që përfitohet nga shërbimi i ofruar si dokument identifikimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijes ose personave të tjerë që mund të punojnë dhe të udhëtojnë me këto anije. Edhe këto të ardhura derdhen çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Të ardhurat nga shërbimet janë të ardhura që përfitohen nga tarifat e regjistrimit të mjeteve lundruese, këto të ardhura derdhen në Buxhetin e Shtetit. Të ardhurat nga shitja e Aktiveve të Qëndrueshme, janë të ardhura të siguruar nga shitja e mjeteve apo pajisjeve të nxjerra jashtë përdorimit. Për vitin 2023, të ardhurat në total janë në vlerë 25,327,245 lekë ndërsa për vitin 2024 të ardhurat në total janë në vlerën 27,602,613 lekë, rritje në vlerën 2,275,368 dhe për 9 mujorin e vitit 2025 janë në vlerën 26,055,283 lekë.

III. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor.

Tabela nr.9: Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve për vitin 2023 në mënyrë të përmbledhur për Drejtorinë e Përgjithshme Detare paraqitet në tabelën e mëposhtme: 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2023	Plani i çelur 2023	Realizimi i shpenzimeve 2023	% e realizimit
Shpenzime për paga (600)	86,323	91,343	91,311	100
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	14,427	16,027	15,101	94.2
Shpenzime operative (602)	17,000	16,956	13,055	77
Transferta tek individët (606)	254	298	296	99.3
Shpenzime për Investime (231)	8,329	8,329	8,118	97.5
Total	126,333	132,953	127,881	96.2

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Plani vjetor fillestar për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 126,333 mijë lekë plani i çelur për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 132,953 mijë lekë dhe realizimi shpenzimeve është 127,881

mijë lekë ose në masën 96 %. Për vitin 2023 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 9,134 mijë lekë dhe janë realizuar 91,131 mijë lekë ose në masën 100%, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 16,027 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 15,101 mijë lekë ose në masën 94%. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 16,956 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 13,055 mijë lekë ose në masën 77 %. Janë planifikuar fonde për investime në shumën 8,329 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 8,118 mijë lekë, ose në masën 97.5% për 3 projekte.

Tabela nr.10: Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve për vitin 2024 në mënyrë të përmbledhur për Drejtorinë e Përgjithshme Detare të paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2024	Plani i çelur 2024	Realizimi i shpenzimeve 2024	%
Shpenzime për paga (600)	115,997	104,997	101,410	96.6
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	19,192	19,192	16,746	87.2
Shpenzime operative (602)	19,250	19,250	12,640	65.7
Transferta tek individët (606)	320	398	398	100
Shpenzime per Investime (231)	35,156	35,156	10,505	30
Total	189,915	178,993	141,699	79.2

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Plani vjetor fillestar për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 189,915 mijë lekë plani i çelur për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 178,993 mijë lekë dhe realizimi shpenzimeve është 141,699 mijë lekë ose në masën 79 %. Për vitin 2024 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 104,997 lekë dhe janë realizuar 101,410 lekë ose në masën 96 %, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 19,192 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 16,746 mijë lekë ose në masën 87 %. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 19,250 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 12,640 mijë lekë ose në masën 65 %. Janë planifikuar fonde për investime në shumën 35,156 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 10,505 mijë lekë, ose në masën 30% për 2 projekte. Zëri i investimeve është me performancë të ulët sepse në planin e buxhetit nuk është realizuar investimi “Blerje motoskafi” me vlerë 7,655,518 lekë përshkak sepse në procedurë nuk u paraqit asnjë ofertues dhe investimi “Blerje mobilie zyrash” me vlerë të planifikuar në planin e buxhetit 15,500 mijë lekë është realizuar në vlerën 3,000 mijë lekë.

Tabela nr.11: Realizimi i buxhetit në drejtim të shpenzimeve për vitin 2025 në mënyrë të përmbledhur për Drejtorinë e Përgjithshme Detare të paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Shpenzimet sipas llogarive ekonomike	Plani vjetor fillestar 2025	Plani i çelur 2025	Realizimi i shpenzimeve 2025/9 mujor	%
Shpenzime për paga (600)	135,997	135,997	82,050	60.3
Shp. për sig shoq e shëndetësore (601)	2,3083	23,083	13,633	60
Shpenzime operative (602)	19,250	19,250	7,177	37.2
Transferta tek individët (606)	124	174	174	100
Shpenzime per Investime (231)	32,923	32,923	107,49	32.6
Total	211,377	211,427	113,783	54

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Plani vjetor fillestar për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 211,377 mijë lekë plani i çelur për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 211,427 mijë lekë dhe realizimi shpenzimeve është 113,783 mijë lekë ose në masën 54 %. Për vitin 2025 janë planifikuar shpenzime për paga në vlerën 135,997 mijë lekë dhe janë realizuar 82,050 mijë lekë ose në masën 60.3 %, shpenzime për sigurime shoqërore janë planifikuar në vlerën 23,083 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 13,633 mijë lekë ose në masën 60 %. Shpenzime operative janë planifikuar në vlerën 19,250 mijë lekë dhe janë

realizuar në vlerën 7,177 mijë lekë ose në masën 37 %. Janë planifikuar fonde për investime në shumën 32,923 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 10,749 mijë lekë, ose në masën 32 % për 6 projekte.

IV. Raportet e Monitorimit.

Nga auditimi lidhur me raportet e monitorimit rezultoi se, për vitin 2023 janë dërguar në MFE raportet e detajuara “*Raport monitorimi Janar-Prill 2023*” me shkresën nr.701/1 prot., datë 12.05.2023. “*Raport monitorimi Janar-Gusht 2023*” me shkresën nr. 2024 prot., datë 15.09.2023. Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2023 me shkresën nr.131/1 prot., datë 15.02.2024.

Për vitin 2024 janë dërguar në MFE raportet e detajuara “*Raport monitorimi Janar-Prill 2024*” me shkresën Nr.1536/1 prot., datë 17.05.2024.“*Raport monitorimi Janar-Gusht 2024*” me shkresën nr. 2447 prot., datë 14.09.2024. “*Raporti i monitorimit Janar-Dhjetor 2024*” me shkresën nr. 218/1 prot., datë 10.02.2025.

Për vitin 2025 janë dërguar në MFE raportet e detajuara “*Raport monitorimi Janar-Prill 2025*” me shkresën nr.1196/1 prot., datë 16.05.2025.“*Raport monitorimi Janar-Gusht 2025*” me shkresën nr.2428/1 prot., datë 12.09.2025.

Nga auditimi u konstatua se, në përmbajtjen e raporteve të monitorimit, subjekti ka përshkruar/pasqyruar veprimtarinë e institucionit, si dhe të dhëna në terma sasiorë por nuk është kryer një analizë e mirëfilltë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit.

Gjithashtu është konstatuar se në raportin 12 mujor të vitit 2024 nuk janë përgatitur anekset 1 aneksi 1.1 dhe aneksi 1.2 ku bazuar në Udhëzimin nr. 14 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore*” ku specifikohet se Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe Institucionet Qendrore duhet të përmbajë: Informacionin sipas formatit standard narrativ të raportit të monitorimit të buxhetit, të përcaktuar në shtojcën 3, të këtij udhëzimi; Aneksit e monitorimit, aneksi nr.1 “*Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor*” aneksi nr.1.1 “*Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve*” aneksi nr.1.2 “*Shpenzimet buxhetore në total Programi dhe Total ministrie/institucioni qendror, sipas artikujve*”; Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 49 të udhëzimit nr.14 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore*”. Udhëzimin nr.9, datë 20.7.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, pika 267.

Për sa është trajtuar në Projekt raportin e auditimit, nga Drejtoria e Përgjithshme Detare është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2684/12 prot., datë 12.02.2026, administruar në KLSH me praktikën nr.1050/6 prot., datë 16.02.2026, nga z. T. H. Drejtor i Përgjithshëm, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar konstatimit tuaj ju sqarojmë se: Raportet e monitorimit për 12 mujorin e vitit 2024 janë përgatitur dhe dërguar ne Institucionin nga ne jemi në vartësi ne përputhje me kërkesën shkresës të MIE Nr.1026 Prot. date 03.02.2025, dhe është përgatitur dhe plotësuar sipas :

- Aneksit nr.2, Raport mbi ekzekutimin e Buxhetit ne nivelin e Programit te Buxhetit.
- Raporti nr.2/1, Shpenzimet e programit sipas artikujve.
- Aneksi nr.3, Raporti i performancës së produkteve te programit.
- Aneksi nr.3.1, Raporti i performancës se produkteve te programit sipas artikujve.

- Aneksi nr.3.2, Deviacioni i kostos për njësi ne vite.
- Aneksi Nr.4, Raporti i realizim të treguesve te performances se programit.
Anekset nr. 1, nr.1.1 dhe aneksi nr.2 janë te pasqyruar ne 6 anekset e përmendura me sipër, pasi janë te njëjtët komponente, të njëjta te dhëna që kërkohen, pavarësisht nr në fillim qe ka aneksi. Po kështu ne Relacionin b/lidhur Raporteve te Monitorimit është kryer edhe analiza e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik buxhetor ne :
-Shpenzime për paga e sigurime shoqërore;
- Shpenzime operative bazuar edhe realizimit te Regjistrimit te prokurimeve për vitin 2024;
- Shpenzime për Investime me financim te brendshëm bazuar statusit te tyre juridik;
- Shpenzime për Investime me financim te huaj bazuar statusit te tyre juridik;
Qëndrimi i grupit të auditimit: Në përgjigje të observacionit tuaj sqarojmë se, pretendimet e ngritura kanë të njëjtin karakter me ato të trajtuara në PRA të pa mbështetura me dokumentacion, dhe janë të karakterit justifikues. *Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.*

2.2. Auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë.

Në zbatim të pikës nr.2 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletë-hyrje, fletë-dalje, faturë, mandat-arkëtim, mandat-pagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Shpenzimet për udhëtime dhe dieta;
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime
- Shpenzimet për investime

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Për auditimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së veprimeve të kryera me arkë dhe bankë, në valutë dhe në lekë, nga grupi i auditimit u përzgjedhën për auditim veprimet e kryera në 6-mujorin e dytë të vitit 2023, 3-mujorin e parë dhe 5-mujorin e fundit të vitit 2024, si dhe 3-mujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2025.

Nga kontrolli financiar i ushtruar mbi pagesat e kryera me urdhër shpenzimi nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre, përveç rasteve të dietave brenda vendit. Është kryer regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt i veprimeve dhe, në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të kryera nëpërmjet bankës përputhet me ekstraktin bankar përkatës, për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit.

Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve rezulton se shpenzimet janë regjistruar me numra rendorë, në mënyrë kronologjike. Urdhër-shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës, si fatura, kontrata të lidhura për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, procesverbale, si dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

Dieta Brenda Vendit:

Nga auditimi i praktikave të shpenzimeve të udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi, bazuar në VKM Nr. 997, datë 10.12.2010 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*”, i ndryshuar, u konstatuan mangësitë si më poshtë vijon:

Viti 2023

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 196, datë 21.08.2023, janë paguar 6 punonjës në vlerën 206,900 lekë. Plani i punës është hartuar nga Drejtori i Sigurisë Portuale dhe Administrimit e Kontrollit të Flamurit (DSPKT) pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 197, datë 21.08.2023, është paguar një punonjës në vlerën 25,120 lekë, i cili rezulton të jetë vetë Drejtori i DSPKT-së. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 198, datë 21.08.2023, është paguar 1 punonjës në vlerën 12,560 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 235, datë 06.10.2023, janë paguar 6 punonjës në vlerën 147,620 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 236, datë 06.10.2023, është paguar një punonjës në vlerën 24,280 lekë, i cili rezulton të jetë vetë Drejtori i DSPKT-së. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 244, datë 16.10.2023, janë paguar 2 punonjës në vlerën 43,400 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 245, datë 16.10.2023, është paguar një punonjës në vlerën 18,060 lekë, i cili rezulton të jetë vetë Drejtori i DSPKT-së. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 299, datë 20.12.2023, janë paguar 5 punonjës në vlerën 83,950 lekë. Për 2 punonjës, shpenzimet e udhëtimit dhe dietat janë në vlerën 32,890 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 300, datë 20.12.2023, është paguar një punonjës në vlerën 16,500 lekë, i cili rezulton të jetë vetë Drejtori i DSPKT-së. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 315, datë 28.12.2023, janë paguar 2 punonjës në vlerën 44,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 316, datë 28.12.2023, është paguar një punonjës në vlerën 11,780 lekë, i cili rezulton të jetë vetë Drejtori i DSPKT-së. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.

Viti 2024

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 203, datë 06.09.2024, janë paguar 3 punonjës në vlerën 23,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 204, datë 06.09.2024, është paguar një punonjës në vlerën 5,500 lekë, i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 234, datë 10.10.2024, janë paguar 3 punonjës në vlerën 27,500 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 235, datë 10.10.2024, është paguar një punonjës në vlerën 5,500 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.
- Në urdhrin e shpenzimit nr. 271, datë 08.11.2024, janë paguar 3 punonjës në vlerën 29,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 272, datë 08.11.2024, është paguar një punonjës në vlerën 6,000 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 313, datë 27.12.2024, janë paguar 3 punonjës në vlerën 58,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 314, datë 27.12.2024, është paguar 1 punonjës në vlerën 12,500 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 328, datë 31.12.2024, janë paguar 4 punonjës në vlerën 33,160 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 329, datë 31.12.2024, është paguar një punonjës në vlerën 5,500 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.

Viti 2025

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 86, datë 29.04.2025, janë paguar 3 punonjës në vlerën 44,500 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 87, datë 29.04.2025, është paguar një punonjës në vlerën 22,500 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 128, datë 17.06.2025, janë paguar 3 punonjës në vlerën 38,660 lekë. Për 2 punonjës, shpenzimet e udhëtimit dhe dietat janë në vlerën 23,000 lekë. Plani i punës është Hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 158, datë 14.07.2025, janë paguar 2 punonjës në vlerën 29,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

- Në urdhrin e shpenzimit nr. 159, datë 14.07.2025, është paguar një punonjës në vlerën 11,000 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 209, datë 08.09.2025, janë paguar 5 punonjës në vlerën 88,000 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 210, datë 08.09.2025, është paguar 1 punonjës në vlerën 16,500 lekë. Plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

– Në urdhrin e shpenzimit nr. 211, datë 08.09.2025, janë paguar 2 punonjës në vlerën 16,500 lekë. Për 1 punonjës, shpenzimet e udhëtimit dhe dietat janë likuiduar në vlerën 11,000 lekë i cili rezulton të jetë vetë drejtori i DSPKT. Për këtë pagesë nuk ekziston asnjë autorizim apo plan pune i firmosur nga titullari i institucionit. Ndërsa për punonjësit tjetër plani i punës është hartuar nga drejtori përkatës, pa u marrë miratimi paraprak i titullarit.

Grupi i auditimit konstatoi se në të gjithë rastet e sipërcituara urdhri i titullarit për rimbursimin e shpenzimeve me dieta është nxjerrë pas kryerjes së shërbimit. Veprimet e mësipërme janë ne kundërshtim”. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku kërkohet miratim para faktit nga titullari për përdorimin e fondeve publike; Nenin 4/26, pika 17 “Kontrolle para faktit”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 35 shkronja b “Dokumenta autorizues” dhe pika 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” si dhe Urdhrin nr. 1020/1, datë 17.05.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Për delegim kompetencash”, sipas të cilit autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të DPD, jashtë qendrës së punës dhe në distanca mbi 100 km, jepen vetëm nga

Drejtori i Përgjithshëm i DPD;

Gjithashtu nga verifikimi i faturave të transportit të paraqitura si dokumentacion justifikues, konstatohet se këto fatura nuk janë të fiskalizuara, duke qenë se fiskalizimi i çdo fature për mallra dhe ose shërbime të kryera përbën kriterin për njohjen e tyre për shpenzim e kryer.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, neni 3 dhe neni 8, si dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 16, datë 03.04.2020, i ndryshuar, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku kërkohet miratim para faktit nga titullari për përdorimin e fondeve publike; Nenin 4/26, pika 17 “Kontrolle para faktit”.

Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 35 shkronja b “Dokumenta autorizues” dhe pika 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Urdhrin nr. 1020/1, datë 17.05.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “Për delegim kompetencash”, sipas të cilit autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të DPD, jashtë qendrës së punës dhe në distanca mbi 100 km, jepen vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD;

Këto parregullësi administrative në procesin e autorizimit dhe dokumentimit të shpenzimeve kanë sjellë si pasojë cenimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke kryer shpenzime pa miratim paraprak të Titullarit.

- Me Urdhrin e Shpenzimit nr. 246, datë 21.10.2024, është realizuar pagesa në vlerën 697,800 lekë për shërbimin e blerjes dhe mirëmbajtjes së godinës së Kapitanerisë së Portit të Durrësit. Referuar faturës Tatimore të lëshuar nga subjekti me nr. 9/2024, datë 15.10.2024.

Kontrata është lidhur me nr. 2384/3, datë 09.10.2024, me afat zbatimi 10 ditë nga data e nënshkrimit.

Me Urdhrin nr. 2384/4, prot., datë 15.10.2024, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i cili në të njëjtën datë ka konstatuar se shërbimet janë kryer dhe marrë në dorëzim sipas zërave, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë.

Grupi i auditimit konstatoi se AK nuk ka përcaktuar një mbikëqyrës për mbikëqyrjen e punimeve dhe një kolaudatori për kolaudimin e tyre pasi Autoriteti kontraktore nuk ka kryer klasifikimin e duhur të punimeve të objektit si mirëmbajtje apo rikonstrukcion. Por nëse shohim preventivin e punimeve vihet re se kemi të bëjmë me punime të mirëfillta rikonstrukcioni dhe kemi të bëjmë me zëra pune si: *Suva e zakonshme fasadë mur tulle h-8m, skele metalike me tubo fasade >12m etj.* Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” nenet 7, 2, 5, 8 etj Neni 7: *Për të gjitha llojet e objekteve duhet të vendoset detyrimisht mbikëqyrësi i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me zbatuesin e objektit që do të drejtojë.*

Në rastin kur gjykohet nga investitori, në rolin e mbikëqyrësit caktohet një punonjës i investitorit, gjithmonë i pajisur me licencën përkatëse.

Neni 2 - Përcakton që çdo punim ndërtimi duhet të jetë i mbikëqyruar nga një subjekt i licencuar.

Neni 5 - Definin përgjegjësitë dhe detyrat e mbikëqyrësit të punimeve ndërtimore.

Neni 8 - Përcakton se mbikëqyrësi duhet të sigurojë që punimet të jenë në përputhje me projektin dhe normat teknike të ndërtimit.

kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

Neni 17. Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen

dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve. PAGESA MUND TË KRYHET VETËM NË BAZË TË KËTJË MIRATIMI. KËTO DOKUMENTE DËRGOHEN NË SEKTORIN FINANCIAR TË PUNËDHËNËSIT, BASHKË ME VËRTETIMIN E PËRKOHSHËM TË PAGESËS, PËR TË SHPALLUR VLERËN E DETYRUESHME PËR PAGIM.

3. Auditim mbi evidencën kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij nga organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese 2023-2024.
- Ditarët e kontabilitetit për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Listë pagesat me përzgjedhje për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhat raportuese ushtrimore 2023-2024.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit, për vitin ushtrimor 2023-2024.
- Dokumentet e inventarizimit etj., për vitin ushtrimor 2023-2024.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtorja e Financës.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2023-2024:

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. Bilanci i vitit 2023 është përgatitur nga znj. B. T. me detyrë Përgjegjës i financës dhe janë konfirmuar nga Drejtor i Përgjithshëm, z. P. N. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Durrës në datën 06.03.2024, brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Bilanci i vitit 2024 është përgatitur nga z. B. T. me detyrë Përgjegjës i financës dhe janë konfirmuar nga zv.Drejtor i Përgjithshëm, z. T. H. në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Durrës në datën 13.03.2024.

Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.

Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht ditarët analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Format 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Format 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Format 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Format 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Format 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Format 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Format 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);

- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruar nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2023 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **2,075 mijë lekë** për shpenzimet dhe **410 mijë lekë** për të ardhurat, sipas **aneksit nr. 2/3/1** e paraqitur në anekset e projekt raportit të auditimit: Për vitin 2024 marrë në konsideratë vlerën e precizionit **2,230 mijë lekë** për shpenzimet dhe **497 mijë lekë** për të ardhurat, sipas **aneksit nr. 2/3/2** e paraqitur në anekset e projekt raportit të auditimit.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023-2024:

Mbajtja e kontabilitetit:

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar etj.

Bilanci kontabël:

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2023 dhe 2024.

Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.

Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.

Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse .

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në 31.12.2023 dhe 31.12.2024, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2023.

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=	280,834,447 lekë.
- Aktivet	293,642,275 lekë
- Detyrimet	12,807,828 lekë
- Aktivet Neto	280,834,447 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **39,190,165 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 8,064,294 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 21,073,666 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 10,029,725 lekë;

Pasqyra e pozicionit financiar (F1) 2024.

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=280,834,447 lekë.**

- Aktivet	276,786,430 lekë
- Detyrimet	14,237,849 lekë
- Aktivet Neto	262,548,581 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **40,753,935 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 9,212,542 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 20,173,167 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 11,379,425 lekë;

Fondi i Konsoliduar:**Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficit i akumuluar)**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela nr.12: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101 (viti 2023)		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	45,592,820	273,334,946	Çelje
Amortizim i vitit	(19,403,613)	19,136,102	Investime + Dhurime
Shuma	26,189,207	292,471,048	Shuma
Shuma		266,281,841	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 “Teprica” është kontabilizuar për vlerën 266,281,841 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Tabela nr.13: Detajet e nënrubrikës “Teprica”.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101 (viti 2024)		Zerat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Pakësimet gjatë vitit	9,849,557	266,281,841	Çelje
Amortizim i vitit	15,044,826	6,474,768	Investime + Dhurime
Shuma	24,894,383	273,657,108	Shuma
Shuma		247,862,226	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Referuar pasqyrës së pozicionit financiar llogaria 101 “Teprica” është kontabilizuar për vlerën 248,762,725 lekë. Kjo llogari është kontabilizuar në përputhje me udhëzimin e MFE-së nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” .

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Drejtoria e Përgjithshme Detare është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2684/12 prot., datë 12.02.2026, administruar në KLSH me praktikën nr.1050/6 prot., datë 16.02.2026, nga z. T.H. Drejtor i Përgjithshëm, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Referuar gjetjes së mësipërme po shprehim analizën si mëposhtë për vitet 2023-2024.

Për vitin 2023 llogaria 101 "Tepricat (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar kreditimet janë si mëposhtë:

- Celje në vlerën 273,334,946 lekë;
- Investime dhe dhurime në vlerën 19,136,102 lekë;

Debitimet në llogari gjatë vitit 2023;

- Pakësimet gjatë vitit në vlerën 45,592,820 lekë;
- Amortizim i vitit 19,403,613 lekë;

Për vitin 2024 llogaria 101 "Tepricat (Fond i akumuluar)/ Deficit i akumuluar kreditimet janë si mëposhtë:

- Celje në vlerën 266,281,841 lekë;
- Investime dhe dhurime në vlerën 6,474,768 lekë;

Debitimet në llogari gjatë vitit 2024;

- Pakësimet gjatë vitit në vlerën 9,849,557 lekë;
- Amortizim i vitit 15,044,826 lekë;

"Ndryshimi i gjendjes së inventarit" ka kaluar në llogarinë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" bashkë me kalimet e tjera të shpenzimeve dhe të ardhurave të vitit 2024 dhe jo në llogarinë 101 "Teprica (Fond i kushtëzuar).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm dhe analizimit të llogarisë për debitimet dhe kreditimet e llogarisë 101 "Teprica" merren në konsideratë në hartimin e Raportin të Auditimit.

Tabela nr.14:Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
531	Mjete Monetare në arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	6,342,918	5,308,670	1,034,248
520	Disponibilitete në thesar	2,869,623	2,755,623	114,000
50	Letra me vlerë	--	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akreditiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provgjione zhvlerësimi letra me vlerë	-	-	-
	Totali	9,212,542	8,064,294	1,148,248

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 2,869,623 lekë, përbëhet nga: gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 133,749 lekë gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 2,869,623 lekë.

Vlera e arketuar por e pa derdhur e Taksës Portuale e muajit Dhjetor e vitit 2024=48,380 lekë, vlera e arketuar por e pa derdhur e muajit dhjetor e pasaportes së lundrimit=63,250 lekë

Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Drejtoria e Përgjithshme Detare është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2684/12 prot., datë 12.02.2026, administruar në KLSH me

praktikën nr.1050/6 prot., datë 16.02.2026, nga z. T. H. Drejtor i Përgjithshëm, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Përsa i përket konstatimit tuaj se llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” e vitit 2024 në shumën 2,869,623 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 85 “Rezultat i vitit ushtrimor”, fondet për taksën portuale dhe pasaportën e lundrimit janë fonde të cilat i kalojnë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të mësipërm dhe analizës së përcjellë nga Drejtoria e Financës për kuadrumin e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” merret në konsideratë në hartimin e Raportit të Auditimit.

Llogaria 512 “Mjete monetare në bankë”.

Në këtë llogari janë kontabilizuar vlera e projekteve të huaja. Në datën 31.12.2024 është paraqitur në vlerën 6,342,918 lekë.

Projektet e huaja paraqiten si më poshtë:

- Projekti Medea 238,635 lekë.
- Projekti Bluwbc 110,186 lekë.
- Projekti Development of Master Program 43,746 lekë.
- Projekti Eurmarsi 5,062,079 lekë.
- Projekti zero 888,270 lekë.

➤ **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”:**

Tabela nr.15: Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
31	Materiale	16,718,945	17,548,837	(829,892)
32	Inventar i imët	3,454,221	3,524,828	(70,607)
33	Prodhim në proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	-	-	-
36	Kafshë në rritje e majmëri	-	-	-
37	Gjendje të pambëritura ose pranë të tretëve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarëve	-	-	-
	Totali	20,173,167	21,073,666	-

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në 31.12.2024 paraqitet në vlerën 20,173,167 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 16,718,945 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 3,454,221 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën = 900,499 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 900,499 lekë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 17,548,837.72 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie 31 “Materiale” për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.16: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	18,235,645.18
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	4,196,542
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	4,883,349.46
Gjendja në 31.12.2023	17,548,837.72

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 16,718,945.14 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.17: Detajet e llogarisë 312 “Materiale”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	17,548,837.72
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	3,947,232
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	4,777,124.58
Gjendja në 31.12.2024	16,718,945.14

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 3,524,828.38 leke dhe lëvizjet e kesaj llogarie 32 “Objekte inventari” per vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.18: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	2,330,115
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	1,647,845.34
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	453,131.96
Gjendja në 31.12.2023	3,524,828.38

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 327 “Inventar i imët”, ka vlerën 3,454,221.88 dhe lëvizjet e kesaj llogarie 32 “Objekte inventari” per vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.19: Detajet e llogarisë 327 “Inventar i imët”.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	3,524,828.38
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	467,457.14
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	538,063.64
Gjendja në 31.12.2024	3,454,221.88

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2023 dhe 2024, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e titullarit të Institucionit është konceptuar dhe firmosur Urdhëri Nr. 129 datë 24.10.2023, Nr.130 datë 24.10.2023, Urdheri Nr.131 datë 19.11.2024, Nr.132 datë 19.11.2024 për ngritjen e komisionit të Inventarizimit, dhe Vlerësimit të aktiveve për vitin 2023-2024 të Institucionit Drejtoria e Pergjithshme Detare të ndara sipas Kapitenerive.

Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit per vitin 2023-2024 ka në përbërje:

Komisioni Inventarizimit:

Viti 2023	Viti 2024
Drejtoria e Përgjithshme Detare	
1- M.K.	1- D.Xh.
2- E. K.	2- E.Xh.

3- H. H.	3- J.Sh.
Kapiteneria e Portit Vlorë	Kapiteneria e Portit Vlorë
1- L. R.	1- L. R.
2- B.S.	2- A. B.
3- E. C.	3- A. B.
Kapiteneria e Portit Sarandë	Kapiteneria e Portit Sarandë
1- F. K.	1- F. K.
2- I. D.	2- Xh. B.
3- E.G.	3- A.Sh.
Kapiteneria e Portit Shëngjin	Kapiteneria e Portit Shëngjin
1- Sh.C.	1- Sh. C.
2- I.Sh.	2- A.M.
3- J.B.	3- P. V.
Komisioni Vleresimit	
Viti 2023	Viti 2024
1- B. T.	1- F.I.
2- K.S.	2- B.T.
3- R.T.	3- R.T.
Komisioni Asgjesimit:	
Viti 2023	Viti 2024
1- F. I.	1- K.S.
2- E. T.	2- K.H.
3- K.B.	3- D.B.
4- G.D.	4- F.Gj.
5- Gj.K.	5- P.T.

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Referuar urdhrorit nr.129, datë 24.10.2023 të D.P.D Durrës komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin dhe me shkresat si mëposhtë ka informuar titullarin e institucionit.

-Me shkresën nr.2208/1 prot, datë 08.11.2023, Kapiteneria Durrës ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 218 (1 copë);
- Ilogaria 327 (98 copë);

-Me shkresën nr.2208/2 prot, datë 08.11.2023, Kapiteneria Shëngjin ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 218 (2 copë);
- Ilogaria 327 (8 copë);

-Me shkresën nr.2208/3 prot, datë 09.11.2023, Kapiteneria Shëngjin ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 327 (10 copë);

-Me shkresën nr.2208/4 prot, datë 10.11.2023, Kapiteneria Vlorë ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 327 (12 copë);

Komisioni i Vlerësimit me procesverbalin me datë 28.12.2023 ka vlerësuar për të dalë jashtë përdorimit materialet si mëposhtë.

- Ilogaria 218 (3 copë) me vlerë 234,660 lekë.

- Ilogaria 327 (128 copë) me vlerë 87,214 lekë.

Komisioni i Asgjesimit me procesverbalin me datë 28.12.2023 ka nxjerrë jashtë përdorimit materialet si mëposhtë.

- Ilogaria 218 (3 copë) me vlerë 234,660 lekë.
- Ilogaria 327 (128 copë) me vlerë 87,214 lekë.

Me urdhër nr.17, datë 01.02.2023 *“Për miratimin e propozimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vlerësuara të Drejtorisë së Përgjithshme Detare”*, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve me vlerë historike 45,358,160 lekë dhe vlerë të mbetur të rivlerësuar 269,782 lekë.

Tabela nr.20: Mjetet e nxjerra jashtë përdorimit

Nr	Emërtimi	Sasia	Cmimi	A.Akumuluar	Vlera e mbetur e rivlerësuar
1	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
2	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
3	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
4	Autovetura Rexton AA	1	3,200,160	3,200,160	48,002
5	Autovetura Frontera DR7	1	2,198,000	2,198,000	21,980
Total			45,358,160	45,358,160	269,782

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Me urdhër ankandi nr.01, datë 06.03.2023 *“Për shitjen e ankand të 3 (tre) motoskafe tip rapace, automjet tip rexton dhe automjet opel frontera”* me vlerë fillestare ankandi 269,782 lekë.

Me datë 19.06.2023 u mbajt procesverbali për hapjen e ofertave për procedurën *“Shitje ankandi”*. Në ankand është paraqitur *“Xh.H.”* PF me vlerë të ofruar 270,000 lekë.

Me procesverbalin me nr.179/8 prot, datë 27.06.2023 i mbajtur nga komisioni *“Shqyrtimi i dokumentacionit procedura shitje me ankand të 3 (tre) motoskafeve tip rapace, automjet tip rexton dhe frontera”*.

Me procesverbalin me nr.179/9 prot, datë 27.06.2023 i mbajtur nga komisioni *“Klasifikimi përfundimtar i ofertave”*, me vlerë oferte 270,000 lekë OE Xh. H. me nipt K5.

Kontrata midis Autoritetit dhe Kontraktorit është lidhur më datë 25.07.2023.

Me urdhër të brendshëm nr. 95, datë 02.08.2023 *“Për dorëzimin e mjeteve të shitura në ankand”*. Me procesverbalin nr.1806/1 prot, datë 03.08.2023 janë dorëzuar automjetet me targa DR7 dhe AA 67

Me procesverbalin nr.15/08 prot, datë 15.08.2023 është dorëzuar mjetin motoskaf i Kapitenerisë Shëngjin.

Me procesverbalin nr.18/08 prot, datë 18.08.2023 është dorëzuar mjetin motoskaf i Kapitenerisë Sarandë.

Me procesverbalin nr.17/08 prot, datë 17.08.2023 është dorëzuar mjetin motoskaf i Kapitenerisë Vlorë.

Referuar procedurës së mësipërme gjatë vitit 2023 për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve është vepruar në përputhje me udhëzimin nr.30 *“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” pikat 73-118.*

Inventarizimi 2024:

Referuar urdhrorit nr.131, datë 19.11.2024 të D.P.D Durrës komisioni i inventarizimit ka kryer inventarizimin dhe me shkresat si mëposhtë ka informuar titullarin e institucionit.

-Me shkresën nr.2757/4 prot, datë 12.12.2024, Kapiteneria Durrës ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 214 (29 copë);
- Ilogaria 218 (21 copë);
- Ilogaria 327 (160 copë);

-Me shkresën nr.2757/2 prot, datë 10.12.2024, Kapiteneria Vlorë ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 214 (7 copë);
- Ilogaria 218 (50 copë);
- Ilogaria 327 (7 copë);

-Me shkresën nr.2757/3 prot, datë 12.12.2024, Kapiteneria Sarandë ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 214 (7 copë);
- Ilogaria 218 (3 copë);
- Ilogaria 327 (6 copë);

-Me shkresën nr.2208/4 prot, datë 10.11.2023, Kapiteneria Shëngjin ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Ilogaria 212 (15 copë); libra
- Ilogaria 214 (13 copë);
- Ilogaria 218 (2 copë);
- Ilogaria 327 (8 copë);

Komisioni i Vlerësimit me procesverbalin me datë 23.12.2024 ka vlerësuar për të dalë jashtë përdorimit materialet si mëposhtë.

- Ilogaria 212 (11 copë) me vlerë 10,620 lekë.
- Ilogaria 214 (43 copë) me vlerë 8,972,524 lekë.
- Ilogaria 218 (76 copë) me vlerë 866,413 lekë.
- Ilogaria 327 (160 copë) me vlerë 181,000 lekë.

Komisioni i Asgjesimit me procesverbalin me datë 30.12.2024 ka nxjerrë jashtë përdorimit materialet si mëposhtë.

- Ilogaria 212 (11 copë) me vlerë 10,620 lekë.
- Ilogaria 214 (43 copë) me vlerë 8,972,524 lekë.
- Ilogaria 218 (76 copë) me vlerë 866,413 lekë.
- Ilogaria 327 (160 copë) me vlerë 181,000 lekë.

Referuar procedurës së mësipërme gjatë vitit 2024 për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve është vepruar në përputhje me udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” pikat 73-118.

- **Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”:**

Tabela nr.21: Detajet e nënrubrikës “Llogari të arkëtueshme”.

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme	11,379,425	10,029,725	1,349,700
411	Klientë e llogari te ngjashme	42,019	24,902	17,117
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	-	-	-
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Loka	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-

436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	559,824.90	548,618.13	11,207
44	Institucione te tjera publike	-	-	-
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	679,700	584,700	95,000
4342	Te tjera operacione me shtetin(të drejta)	8,748,181	6,533,161	2,215,020
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	-
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	-	-	-
	Të tjera aktive afatshkurtra	22,479	71,445	(48,966)
409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënies me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	22,479	71,445	(48,966)
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	-	-	-
	Totali	11,401,904	10,101,170	1,300,734

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2023 është në shumën 679,700 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në shumën 929,700 e cila përbëhet nga gjobat e vendosura ndaj anijeve detareve, kapitenëve të anijes dhe ish- punonjësve. Gjobat e kontabilizuara nga drejtoria janë dërguar në zyrën e përmbarimit shtetëror Durrës për vjeljen e detyrimit.

Tabela nr.22: Detajet e nënrubrikës, lëvizjet e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”

Nr	Subjekti	Shuma e Gjorbës
1	A.J	104,700 lekë
2	A. T.	30,000 lekë
3	G.T.	2,000 Eur
4	M.Y.	2,500 Eur
5	Kapiteni i Anijes	950 Eur
6	A.F.	2,500 Eur
	Total	929,700 lekë

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 8,748,181 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Vlera prej 8,748,181 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Tabela nr.23: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	2024	2023
Llogari 401-408	-	-
Paga personeli llog 42	5,930,029	4,495,987
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	781,494	473,455
Sigurime shoqërore llog.435	1,786,000	1,373,156
Sigurime shëndetësore llog.436	250,658	190,563
Totali	8,748,181	6,533,161

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën **8,748,181 lekë** e cila përbëhet :

Pagat e muajit dhjetor 2023 të cilat paguhen në janar të vitit 2024 = 5,930,029 lekë, tatim page i muajit dhjetor 2023 =703,927 lekë, tatim për shpërblimet e dhëna në muajin dhjetor 2023 = 77,567 lekë, sigurimet shoqërore të muajit dhjetor 2023 = 1,786,000 lekë dhe sigurimet shëndetësore të muajit dhjetor 2023= 250,658 leke.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2024 paraqitet në pasqyrat e konsoliduara në vlerën **9,855,540 lekë** e cila përbëhet :

Pagat e muajit dhjetor 2024 të cilat paguhen në janar të vitit 2025 = 6,716,341 lekë, tatim page i muajit dhjetor 2024 = 816,235 lekë, sigurimet shoqerore të muajit dhjetor 2024 = 2,038,085 lekë dhe sigurimet shëndetësore të muajit dhjetor 2024 = 284,879 lekë.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 38,880,00 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 26,804,116 lekë, shtesa gjatë vitit 2023 në vlerën 0 lekë, amortizim i vitit 2023 në vlerën 1,811,383 lekë dhe vlerë neto në vlerën 10,264,501 lekë.

Tabela nr.24: Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” viti 2023

Nr	Emri i Projektit	Viti i rregjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabel neto
1	Studime dhe Kërkime	2015	38,880,000	28,615,499	10,264,501
Shuma			38,880,000	28,615,499	10,264,501

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Tabela nr.25: Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” viti 2024

Nr	Emri i Projektit	Viti i rregjistrimit	Vlera historike	Amortizimi	Vlera kontabel neto
1	Studime dhe Kërkime	2015	38,880,000	30,155,174	8,724,826
Shuma			38,880,000	30,155,174	8,724,826

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2024, paraqiten në shumën 227,307,669 lekë. Në vitin paraardhës 2023, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 244,187,609 lekë. Gjatë vitit 2024 ka patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 6,474,768 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerën 15,044,826 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 9,849,557 lekë.

Tabela nr.26: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale” viti 2023.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime neto 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka, Troje, Terrene	-	-	-	-	-
211	Pyje, Kullota, Plantacione	-	-	-	-	-
212	Ndërtime e Konstruksione	188,929,350	-	9,464,784	-	179,464,566
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-	-	-	-	-
214	Instalime dhe paisje	35,943,343	17,420,059	10,639,112	-	42,724,291
215	Mjete Transporti	11,215,298	4,498,865	(43,115,100)	45,358,160	13,471,103
218	Inventar Ekonomik	10,558,517	-	1,796,208	234,660	8,527,650
Shuma		246,646,509	21,918,924	(19,403,613)	45,592,820	244,187,609

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela nr.27: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale” viti 2024.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2023	Shtesa 2024	Amortizim 2024	Pakësime neto 2024	Gjendja me 31.12.2024
210	Toka, Troje, Terrene	-	-	-	-	-
211	Pyje, Kullota, Plantacione	-	-	-	-	-
212	Ndërtime e Konstruksione	179,464,566	-	8,978,740	10,620	170,475,206
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	-	-	-	-	-
214	Instalime dhe paisje	42,724,290	3,474,768	964,284	8,972,524	36,262,250
215	Mjete Transporti	13,471,103	-	2,636,170	-	10,834,933

218	Inventar Ekonomik	8,527,649	3,000,000	925,957	866,413	9,735,280
	Shuma	244,187,609	6,474,768	15,044,826	9,849,557	227,307,669

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”. Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 179,464,566 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari nuk ka pasur shtesa. Amortizimi i vitit 2024 është në vlerën 8,978,740 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 170,475,206 lekë.

Në këtë llogari referuar analizës analitike të zërave janë kontabilizuar ndërtesat sëbashku me rikonstruksionet që kanë pësuar gjatë viteve për Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Kapiteneritë e Vlorës, Sarandës dhe Lezhës. Këto aktive edhe pse janë në përdorim të Institucioneve të sipërpërmenduar nuk disponohet dokumentacion i cili vërteton pronësinë për këto ndërtesa në kundërshtim me udhëzimin e MFE-së Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”. Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune. Sipas pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2024 paraqitet me vlerë neto kontabël 36,262,250 lekë.

Gjatë vitit 2024 ka blerë me anë të procedurave të prokurimit materiale me vlerë 3,474,768 lekë. Blerje pa pagesë gjatë vitit 2024 janë në vlerën 0 lekë. Amortizimi i vitit 2024 në shumën 964,284 lekë dhe nxjerrjet jashtë përdorimit 8,972,524 lekë.

Tabela nr.28: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Blerje me pagesë	Pa pagesë		Lëvizje brenda aktiveve
			Jashtë sistemit	Brenda sistemit	
1	Drejtoria e Përgjithshme Detare	3,474,768	-	-	-
	Total	3,474,768	-	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela nr.29: Detajet e nënrubrikës “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.histoike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
139,266,982	96,542,692	42,724,290	3,474,768	-	8,972,524	964,284	133,769,226	97,506,976	36,262,250

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Në fund të vitit 2023 në pasqyrën e pozicionit financiar është pasqyruar për vlerën kontabël neto 13,471,103 lekë. Gjatë vitit 2024 kjo llogari nuk ka pasur shtesa. Amortizimi i vitit 2024 në vlerën 2,636,170 lekë. Në fund të vitit 2024 kjo llogari është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 10,834,933 lekë.

Tabela nr.30: Detajet e nënrubrikës “Mjete Transporti”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
66,672,865	53,201,762	13,471,103	-	-	-	2,636,170	66,672,865	55,837,932	10,834,933

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela nr.31: Mjetet e Drejtorisë viti 2023:

Nr	Drejtoria	Emërtimi	Viti i rregjistrimit	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera Neto
1	Drejtoria e Pergjithshme Detare	2 Mjete Mahindra	2023	4,498,865	0	4,498,865
2	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Foristrade Frontera	1999	2,198,000	2,198,000	0
3	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Autoveture Sangyong	2004	3,200,160	3,200,160	0
4	Drejtoria e Pergjithshme Detare	3 Motoskaf Rapac	2005	39,960,000	39,960,000	0
5	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap.Sarande	2015	15,762,000	12,770,494	2,991,506
6	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap Vlore	2005	14,900,000	14,900,000	0
7	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap.Durres	2015	31,512,000	25,531,268	5,980,732
	Shuma			112,031,025	98,559,922	13,471,103

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Gjatë vitit 2023 me anë të ankandit publik janë shitur 5 mjete me vlerë historike 45,358,160 lekë dhe me vlerë neto 269,782 lekë.

Tabela nr.32: Mjetet e shitura me ankand publik

Nr	Emërtimi	Sasia	Cmimi	A.Akumuluar	Vlera e mbetur e rivlerësuar
1	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
2	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
3	Motoskaf	1	13,320,000	13,320,000	66,600
4	Autovetura Rexton AA 677LI	1	3,200,160	3,200,160	48,002
5	Autovetura Frontera DR79-13B	1	2,198,000	2,198,000	21,980
	Total		45,358,160	45,358,160	269,782

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Detare

Gjatë vitit 2024 kanë qenë në pronësi 5 mjete me vlerë historike 66,672,865 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 55,837,932 lekë dhe vlerë neto 10,834,933 lekë. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur shtesa dhe pakësinë në llogarinë 215 “Mjete transporti”.

Tabela nr.33: Mjetet e Drejtorisë viti 2024:

Nr	Drejtoria	Emërtimi	Viti i regjistrimit	Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Vlera Neto
1	Drejtoria e Pergjithshme Detare	2 Mjete Mahindra	2023	4,498,865	841,723	3,657,142
2	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap Sarande	2015	15,762,000	13,368,795	2,393,205
3	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap.Vlore	2005	14,900,000	14,900,000	0
4	Drejtoria e Pergjithshme Detare	1 Motoskaf Kap Durres	2015	31,512,000	26,727,414	4,784,586
	Shuma			66,672,865	55,837,932	10,834,933

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare. Sipas pasqyrave financiare të gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2024 paraqitet në vlerën 9,735,280 lekë. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 218 “Inventari ekonomik” është shtuar me vlerën 1,207,630 lekë.

Tabela nr.34: Shtesat gjatë vitit 2024 në llogarinë 218 “Inventar ekonomik”:

Nr	Njësitë shpenzuese	Pa pagesë		
		Blerje me pagesë	Jashtë sistemit	Brenda sistemit
1	Bashkia	3,000,000	-	-
	Total	3,000,000	-	-

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela nr.35: Detajet e nënrubrikës “Inventar ekonomik”.

Teprica në fillim			Shtesa		Pakësimet		Teprica Ne fund		
K.Historike	A.Akumuluar	Teprica Neto	K.historike	Amortizim	K.Historike	Amortizim	K.historike	A.Akumuluar	Teprica Neto
23,474,509,	14,946,860	8,527,649	3,000,000	-	866,413	925,957	25,608,096	15,872,817	9,735,280

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Detare në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 272,746,541 lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2024. Krahasuar me vitin 2023 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej 13,505,151 lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2024.

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aktivet afatgjata me vlerë neto” që ka të bëjë me amortizimin vjetor 2024.

Tabela nr.36: Detajet e nënrubrikës “Aktivet afatgjata me vlerë neto”.

Nr.Reference Llogarije	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Pakësimet gjatë vitit		Teprica në fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	A.akumuluar	Teprica neto
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	38,880,000	28,615,499	10,264,501	0	0	0	1,539,675	38,880,000	30,155,174	8,724,826
202	38,880,000	28,615,499	10,264,501	0	0	0	1,539,675	38,880,000	30,155,174	8,724,826
21-28	503,428,999	259,241,390	244,187,609	0	0	0	13,505,151	500,054,210	272,746,541	227,307,669
210	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
211	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
212	274,014,642	94,550,076	179,464,566	0	0	10,620	8,978,740	274,004,022	103,528,816	170,475,206
213	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
214	139,266,982	96,542,692	42,724,290	3,474,768	0	8,972,524	964,284	133,769,226	97,506,976	36,262,250
215	66,672,865	53,201,762	13,471,103	0	0	0	2,636,170	66,672,865	55,837,932	10,834,933
218	23,474,509	14,946,860	8,527,649	3,000,000	0	866,413	925,957	25,608,096	15,872,817	9,735,280
Shuma	542,308,999	287,856,889	254,452,110	6,474,768	0	9,849,557	15,044,826	538,934,210	302,901,715	236,032,495

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme Detare më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Tabela nr.37: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2024	Viti 2023
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	0
42	Detyrime ndaj personelit	6,716,341	5,930,029
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	816,235	781,494
435	Sigurime shoqërore	2,038,085	1,786,000

436	Sigurime shëndetsore	284,879	250,658
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	2,869,623	2,755,623
467	Kreditor të ndryshëm	0	0
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	1,003,763	721,719

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura, paraqitet në vlerën 6,716,341 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2024 në shumën 6,716,341 lekë.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 816,235 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar 2024.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 2,038,085 lekë.

Llogaria 436, “Sigurime shoqërore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetsore për pagat e muajit dhjetor që paguhet në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 284,879 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 2,757,993 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Tabela nr.38: Detajet llogarisë “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Nr	Emërtimi i Investimit	Emri i Firmës	466	Shtesa	Paguar deri me	Ngurtesuar	Mbyllja në datë 31.12.2024
			31/12/2023	2024	31.12.2024	31/12/2024	
1	Rikonstruksioni i Kullës	G.C.	1,475,545	-	-	-	1,475,545
2	-	M. Shpk	151,796	-	151,796	-	-
3	-	N.S.	101,198	-	101,198	-	-
4	Blerje paisje Kompiuterike	I. S.	11,089	-	-	-	11,089
5	-	R. C.Shpk	694,954	-	-	-	694,954
6	Blerje paisje Kompiuterike	F.T. Shpk	459	-	-	-	459
7	Blerje paisje Kompiuterike	B.S.	1,671	-	-	-	1,671
8	Blerje paisje Kompiuterike	B. E.	1,821	-	-	-	1,821
9	Blerje paisje Kompiuterike	In.S. Shpk	30,180	-	-	-	30,180
10	-	U. F.	-	-	-	542,274	542,274
	Shuma		2,468,713	-	252,994	542,274	2,757,993

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50, ku përcaktohet:

Pika 30: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50: “Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas

natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”.

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10 ku përcaktohet:

Pika 10: “Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancën financiare” të PF të vitit 2024 në **aneksi nr. 2/3/3** në anekset e projekt raportit të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 133,335 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2024, të cilat në total janë në vlerën 131,194,114 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 102,346,241 lekë.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2024, paraqitet në bilanc në vlerën 16,745,463 lekë.

- Gjendja e llogarisë **602 ‘Blerje mallra e shërbime’** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 12,640,046 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 12,640,046 lekë.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 ‘Transferime për Buxhetet familjare e Individë’** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 398,275 lekë, dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

Vendimet Gjyqësore:

Gjatë vitit 2023-2025 Drejtoria e Përgjithshme Detare nuk ka likuiduar fonde për vendimet gjyqësore.

Aktualisht Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës ka vetëm 1(një) proces gjyqësor me punonjësen R. T. në pozicionin e specialistes së financës.

Më poshtë po paraqesim informacionin për vendimet gjyqësore deri në datën 30.09.2025 për znj. R. T.

1) Referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me nr. Vendimi 2918, datë 12.12.2006, është vendosur rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe të kryeje pagesën prej datës 31.05.2006 deri në ekzekutimin e këtij vendimi.

2) Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës me nr. vendimi 540, datë 03.12.2007 ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 2918, datë 12.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

3) Vendimi nr.4, datë 20.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur, konstatimin e cenimit të të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.540, datë 03.12.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës.

4) Vendimi i Gjykatës Europiane për të të Drejtat e Njeriut (botuar në fletroren zyrtare 114/2015), vendosi detyrimin e shtetit Shqiptar për zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

5) VKM nr.650, datë 22.07.2015 “*Ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 24.03.2015 për çështjen Lako dhe 7 ankime të tjera (nr.38964/2013), përsa u përket shumave të përcaktuara sipas shtojcës nr.2 dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave*”.

6) Vendim nr.702, datë 12.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me objekt pavlefshmëri i titullit ekzekutiv dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës me nr.2918, datë 12.12.2006 lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me nr.540, datë 03.12.2007 pasi detyrimi është përmbushur. Pushimin e veprimeve përmbartimore.

Gjykata vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova.

7) Vendimi me nr.1005, datë 07.12.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit me objekt pavlefshmëri e titullit ekzekutiv me nr. Vendimi 2918, datë 12.12.2006, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës pasi detyrimi është përmbushur ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.702, datë 12.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

8) Vendimi nr.189, datë 28.10.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me objekt pezullimin e veprimeve përmbartimore, vendosi rrëzimin e kërkesë për pezullimin e veprimeve përmbartimore.

9) Sipas vendimit me nr. 4043, datë 07.11.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore konkretisht akt ekspertimin me nr.29.04.2022 nga eksperti kontabël i miratuar si dhe vendimin me nr.08/2219 prot, datë 17.02.2022 të Zyrës Përmbartimore Durrës për caktimin e ekspertit kontabël është vendosur rëzimi i padisë gjykata vendosir rrëzimin e padisë.

Vendimit nr. 2011, datë 02.06.2025 I Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt kundërshtimin e veprimit përmbartimor me nr.08/2219, datë 11.08.2022, përcaktimin e shumës së detyrimit financiar për të cilën Dega e Thesarit Durrës duhet të vendosë masën e sekuestros ndaj debitorit dhe përcaktimin e shumës së detyrimit financiar në përmbushje të detyrimit të mbetur për të cilën debitori duhet të xhirojë në llogarinë e Zyrës Përmbartimore Shtetërore Durrës.

Referuar padisë së mësipërme nga znj. R.T. gjykata ka vendosur:

-Pranimin e ankimit

-Anullimin e veprimit përmbartimor urdhëri i përmbartuesit gjyqësor me nr.08/2219 prot, datë 11.08.2022.

Urdhërimin e Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Durrës për të saktësuar dhe plotësuar urdhrin e sekuestros dhe vijimin e ekzekutimit të titullit për shumat 4,611,970 lekë, që pëfaqëson diferencën e paguar të pagës neto (pra 7,485,213 lekë- 2,873,243 lekë) 3,271,746 lekë për pagimin e kontributeve dhe Tap; 151,000 lekë të përbërë nga shpenzimet përmbartimore dhe të përfaqësimit. Aktualisht çështja është ankimuar nga palët në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

IV.REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2023-2025 dhe 2024-2026 u konstatua se, në Drejtorinë e Përgjithshme Detare nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, për përgatitjen e PBA-ve, pasi nuk ka aktivitet të dokumentuar të saj. Në përgatitjen e PBA-së janë konsideruar kërkesat e paraqitura nga drejtoritë e institucionit dhe janë përpunuar nga Drejtoria e Financës. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1/a, paragrafi 2.5 pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-19 të Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme Detare të marrë masat e nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e Ekipit të Menaxhimit të Programit gjatë procesit për përgatitjen e

PBA-së, për të siguruar një proces planifikimi sa më real të shpenzimeve korrente dhe investimeve, për përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në përmbajtjen e raporteve të monitorimit, subjekti ka përshkruar/pasqyruar veprimtarinë e institucionit, si dhe të dhëna në terma sasiorë por nuk është kryer një analizë e mirëfilltë mbi ndryshimet e zërave buxhetore për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit. Gjithashtu, rezultoi se në raportin e 12 mujorit të vitit 2024 nuk janë përgatitur anekset nr.1, nr.1.1 dhe nr.1.2. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës 49 të Udhëzimit nr.14 të Ministrisë së Financës “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore*” dhe Udhëzimin nr.9, të Ministrisë së Financës datë 20.7.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” i ndryshuar, pika 267. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-19 të Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për monitorimin e zbatimit të Buxhetit, ku të identifikojnë mosrealizimet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i praktikave të shpenzimeve të udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi u konstatuan se, në 29 urdhëra shpenzime urdhri i titullarit për rimbursimin e shpenzimeve me dieta është nxjerrë pas kryerjes së shërbimit pra mbas faktit. Gjithashtu nga verifikimi i faturave të transportit të paraqitura si dokumentacion justifikues, konstatohet se, këto fatura nuk janë të fiskalizuara, i cili përbën kriterin për njohjen e tyre për shpenzim e kryer.

Këto parregullsi administrative në procesin e autorizimit dhe dokumentimit të shpenzimeve kanë sjellë si pasojë cenimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke kryer shpenzime pa miratim paraprak të Titullarit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 “*Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit*”, i ndryshuar, neni 3 dhe neni 8; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, neni 4/26, pika 17 “*Kontrolle para faktit*”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 35 shkronja b dhe pika 36; Urdhrin nr. 1020/1, datë 17.05.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës “*Për delegim kompetencash*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-23 të Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme që urdhrat për dërgimin me shërbim jashtë qendrës së punës të miratohen para kryerjes së shërbimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin e Shpenzimit nr. 246, datë 21.10.2024, është kryer pagesa në vlerën 697,800 lekë për shërbimin e blerjes dhe mirëmbajtjes së godinës së Kapitanerisë së Portit të Durrësit. Referuar faturës tatimore të lëshuar nga subjekti me nr. 9/2024, datë 15.10.2024 kontrata është lidhur me nr. 2384/3 prot., datë 09.10.2024, me afat zbatimi 10 ditë nga data e nënshkrimit.

Me Urdhrin nr. 2384/4, prot., datë 15.10.2024, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, i cili në të njëjtën datë ka konstatuar se shërbimet janë kryer dhe marrë në dorëzim sipas zërave, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë.

Autoriteti kontraktore nuk ka përcaktuar një mbikëqyrës për mbikëqyrjen e punimeve dhe një kolaudatori për kolaudimin e tyre pasi AK nuk ka kryer klasifikimin e duhur të punimeve të objektit si mirëmbajtje apo rikonstruksion. Referuar preventivit të punimeve vihet re se kemi të bëjmë me punime të mirëfillta rikonstruksioni dhe kemi të bëjmë me zëra pune si: *Suva e zakonshme fasadë mur tulle h-8m, skele metalike me tubo fasadë >12m etj.* Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar nenet 7, 2, 5, 8, 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 20-23 të Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor të marrë masa për kryerjen e klasifikimit të saktë të natyrës së punimeve, përpara nisjes së procedurave të prokurimit dhe lidhjes së kontratave, duke përcaktuar në mënyrë të dokumentuar natyrën e punimeve si mirëmbajtje apo rikonstruksion/ndërtim.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024, rezultoi se llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" me datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 2,757 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Në llogarinë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në fund të vitit 2024 janë kontabilizuar në këtë llogari 3 ngurtësime me vlerën 2,181 mijë lekë, për të cilat ka kaluar afati. Për projektet të cilat ka mbaruar afati i garancisë dhe këto investime nuk kanë shfaqur problematika, në bazë të raporteve të vlerësimit të mbajtur duhet të njoftohen subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e garancive të bllokuara. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4" dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-39 të Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Drejtorja e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", duke rakorduar çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm, për likuidimin e garancisë së punimeve, të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 rezultoi se llogaria 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" në datën 31.12.2024 është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vlerën 170,475 mijë lekë. Në këtë llogari referuar analizës analitike të zërave janë kontabilizuar ndërtesat sëbashku me rikonstruksionet që kanë pësuar gjatë viteve për Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Kapiteneritë e Vlorës, Sarandës dhe Lezhës. Këto aktive edhe pse janë në përdorim të Institucioneve të sipërpërmenduar nuk disponohet dokumentacion i cili vërteton pronësinë për këto ndërtesa. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, klasa 2 aktivet afatgjata. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-39 të Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Titullari i Institucionit sëbashku me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për të përfunduar procesin e rregjistrimit të pasurive të cilat janë në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2025

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

